



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.02.2019, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Seancë dëgjimore me zonjën Mimoza Kaçi, propozim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për anëtare e Bordit të AMF-së që do të mbajë edhe postin e nëndrejtorit

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Vullnet Sinaj, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Edmond Haxhinasto, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Përparim Spahiu, Ismet Beqiraj dhe Dashamir Shehi.

Mungojnë:

Agron Shehaj dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Mimoza Kaçi – kandidate për anëtare e Bordit të AMF-së

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përsëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sot në rend të ditës kemi miratimin e procesverbalit për javën e kaluar dhe seancë dëgjimore me zonjën Mimoza Kaçi, propozim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për anëtare e bordit të AMF-së, ku do të mbajë edhe postin e nëndrejtorit.

Fillojmë me pikën e parë. A keni ndonjë vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të lutem.

Edmond Haxhinasto – Në dijeninë time, ne nuk e kemi parë procesverbalin, sepse nuk na është dërguar. Por edhe çështja e sotme akoma nuk na është dërguar. Sugjerimi im është që bashkë me njoftimin për mbledhje të na dërgohet edhe materiali përkatës që të kemi kohë ta lexojmë.

Arben Ahmetaj – Kjo është shumë e drejtë. Në dijeninë time, ka ardhur, por po pyes sekretaren. A u është dërguar deputetëve?

(Diskutim pa mikrofon)

CV-ja është dërguar. Po procesverbali a u është dërguar?

(Diskutim pa mikrofon)

Sekretaria më thotë që nuk ka qenë pjesë e procedurës, megjithatë do ta korrigjojme dhe do ta sjellim edhe procesverbalin.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është zbardhur ende. Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Haxhinasto, ishte një vërejtje me vend, por sekretaria më thotë se CV-ja e zonjës ju ka ardhur.

Fillojmë me pikën e dytë. Relatore është zonja Kushi.

Fjala për ju, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Për sa u takon kërkesave për t'u emëruar anëtar i bordit të AMF-së, ato janë të përcaktuara në nenin 5 të ligjit 9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiarë, të ndryshuar".

Bazuar në analizimin e dokumentacionit të bërë nga Ministria e Financave, por edhe duke pasur prezent faktin që zonja Kaçi për shkak të parashikimeve ligjore është në këtë detyrë dhe emërimi i saj nga Kuvendi ka kaluar përmes të njëjtës procedurë parlamentare, vlerësoj se ajo i plotëson kriteret për t'u emëruar anëtare e bordit, si dhe plotëson kushtëzimet ligjore lidhur me papajtueshmërinë.

Zonja Kaçi plotëson kriterin lidhur me arsimimin, neni 5, pika 2. Ajo ka kryer studimet universitare dhe master në Universitetin Ekonomisë dhe Biznesit në Vjenë, me profilizim në fushën e financës, më konkretisht “Bankingu investues dhe industria e sigurimeve” dhe mban titullin “doktor shkencash” në financë.

Së dyti, plotëson kriterin lidhur me përvojën profesionale, neni 5 pika 3, ku çmohet kontributi i saj dhënë në vijimësi në fushën akademike.

Së treti, plotëson kriteret për integritetin moral dhe profesional. Nuk ka dënime penale me vendim gjykatë të formës së prerë. Përbush kërkesat dhe dispozitat ligjore për konfliktin e interesave, duke plotësuar edhe kushtëzimet e nenit 5, pikat 4 dhe 6.

Së katërti, zonja Kaçi nuk është e angazhuar në funksione drejtuese partiake dhe përbush kriteret ligjore lidhur me konfliktin e interesave, neni 5, pikat 5 dhe 7. Gjithashtu, nuk ka pengesa dhe papajtueshmëri me funksionin për të rikandiduar në këtë post.

Gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të anëtarit të bordit dhe nëndrejtorit ekzekutiv të AMF-së, zonja Kaçi është angazhuar për rritjen e frymës së bashkëpunimit me të gjithë anëtarët e bordit, me qëllim evidentimin dhe dhënien e zgjidhjeve lidhur me problematika specifike në vijimësi. Ajo është angazhuar dhe ka dhënë një kontribut të vlefshëm në drejtim të përbushjes së objektivave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare lidhur me mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe të personave të siguruar, nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare që mbikëqyrën, respektimin e ligjit e të tjera.

Për të gjitha sa më sipër çmohet se kandidatura e zonjës Kaçi është një kandidaturë serioze, që plotëson kriteret ligjore për t'u emëruar anëtar i bordit, ku do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv.

Mbështetur në pikën 7 të nenit 111 të Rregullores së Republikës së Shqipërisë, i sugjeroj komisionit miratimin e kësaj kandidature, pra riemërimin në këtë detyrë të zonjës Mimoza Kaçi.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Kushi!

Unë mendoj të dëgjojmë zonjën Kaçi dhe pastaj, nëse do të ketë ndonjë pyetje apo komente deputetët janë të ftuar t'i bëjnë ato.

Zonja Kaçi, ju lutem, sa më shkurt, sepse ju keni qenë në këtë detyrë dhe CV-ja juaj është e njohur për anëtarët e komisionit.

Mimoza Kaçi – Mirëdita!

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë quhem Mimoza Kaçi, aktualisht mbaj pozicionin e nëndrejtorit ekzekutiv që prej dhjetorit të vitit 2014.

Do të mundohem të bëj një prezantim sa më të shkurtër të jetës time akademike dhe profesionale.

Kam përfunduar studimet e larta dhe masterin në universitetin e Vjenës, në profilizimin financë, të cilat i kam mbyllur në vitin 2005. Në fushën akademike më tej kam vazhduar me studimet e doktoraturës në Fakultetin Ekonomik të Tiranës, të cilat i kam përmbyllur në vitin 2014. Mbjaj gradën shkencore “doktor” dhënë nga ky fakultet dhe e kam mbrojtur pranë Departamentit të Financës.

Për sa i përket eksperiencës time profesionale, unë kam qenë pjesë e administratës publike për 5 vjet me radhë deri në vitin 2010. Paralelisht gjatë kësaj kohe kam qenë edhe trajnuese në kushtet e organizuara nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, por edhe si pedagoge e jashtme në Fakultetin Ekonomik në Departamentin e Financës dhe më pas kam vijuar si pedagoge e jashtme edhe në institucione të arsimit të lartë privat në vend.

Interesi për jetën akademike më nxiti që në vitin 2010 të angazhohem si pedagoge me kohë të plotë në Universitetin Europian të Tiranës, duke u bërë pjesë e stafit të brendshëm të Departamentit të Financës në këtë universitet.

Për sa i përket punës sime tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dua të theksoj që në çdo moment jam angazhuar me përkushtim, përgjegjshmëri dhe seriozitet në përmbushje jo vetëm të detyrave funksionale, por në përballjen e çdo sfide. Kam mbështetur në mënyrë të vazhdueshme implementimin e risive apo të çdo metodologjie moderne në funksion të një zhvillimi dhe zgjerimi të shëndetshëm të tregjeve nën mbikëqyrje.

Krahas detyrave funksionale jam angazhuar në drejtimin e projekteve të rëndësishme që mbështesin zhvillimin e tregut financiar jo bankë, ku më i rëndësishmi është projekti trivjeçar, për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së, me fokus në tregun e fondeve të investimit. Ky projekt vijon të jetë në proces. Këtu është bërë një punë e madhe ku si më

kryesoret do të rendisja draftimin e i dy ligjeve të rëndësishme për tregun e kapitaleve: “Për sipërmarrjet kolektive” dhe ligji “I titujve”.

Kuadri rregullator për tregun e investimeve është plotësuar dhe përmirësuar, gjithashtu është hartuar manuali i mbikëqyrjes me bazë rreziku për këto tregje dhe jemi përgatitur për implementimin e një metodologjie me një qasje të re të mbikëqyrjes me bazë rreziku në tregun e kapitaleve, kjo për herë të parë për këtë treg.

Njëkohësisht për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse është zbatuar një plan shumë i intensiv dhe ambicioz trajnimi për stafin. Progresi dhe puna e bërë në fushën e tregut të kapitaleve, është vlerësuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë, i referohem këtu edhe raportit të fundit të FMN-së, i cili vlerëson përmirësimin e kuadrit rregullativ për tregun financiar jo bankë.

Vlerësimi pozitiv i punës së bërë ishte një faktor kyç edhe për miratimin e një projekti të ri të financuar nga qeveria zvicerane, i cili do të pasojë projektin aktual dhe do të mbështesë punën e Autoritetit në vijim për një periudhë 4-vjeçare për arritjen e objektivave të punës së tij.

Zhvillimi i fondeve të reja të investimit është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e tregut financiar jo bankë, por edhe tregut financiar në tërësi. Kjo tregon se ka interes për alternativa të reja investuese. Por nga ana tjetër duke pasur në konsideratë asetet e tregut të fondeve të investimit, të cilat dominojnë në portofolin e aseteve të tregut financiar jo bankë, mendoj se një rëndësi e veçantë duhet të vijoje t’i kushtohet mbikëqyrjes efektive të këtij segmenti të tregut për vetë rëndësinë sistemike që përmbajnë këto fonde.

Kjo përbën edhe një prej objektivave të mija konkrete për periudhën vijuese.

Për sa i përket tregut të sigurimeve një ndër kontributet e mija ka qenë anëtarësimi në Komitetin e Vlerësimit të Zbatimit në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve. Për herë të parë Shqipëria bëhet pjesë e një prej komiteteve më të rëndësishme në këtë organizatë, duke qenë pjesë e diskutimeve në hartimin e standardeve ndërkombëtare të sigurimit. Janë këto standarde që zbatohen me tej nga rregullatorët dhe mbikëqyrësit në të gjithë botën.

Përmes prezantimeve dhe diskutimeve në konferencat e organizuara nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse dhe rregullatore kam synuar gjithmonë rritjen e vizibilitetit të punës së Autoritetit në shkallë rajonale, por edhe ndërkombëtare, duke promovuar punën e tij të bërë në mbështetje të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje.

Në fushën e tregut të sigurimeve mendoj se një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet sigurimit të detyrueshëm, i cili përbën dhe pjesën kryesore të portofolit të

shoqërive të sigurimit. Është draftuar ligji i ri “ Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili përmban edhe zbatimin e sistemit *bonus-malus*, që mbetet ndër objektivat dhe prioriteti i punës së Autoritetit në vijim.

Mendoj se një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet edhe punës për rritjen e edukimit financiar të publikut, rritjes së besimit të konsumatorit në punën e bërë nga AMF-ja, por edhe ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari në tregjet nën mbikëqyrje. Autoriteti ka një strategji për rritjen e besimit të konsumatorit dhe ka filluar punën për implementimin e planit të veprimit. Si drejtuese e grupit të punës, që ka hartuar këtë strategji mendoj se duhet të vijojë puna për implementimin e të gjitha veprimeve të parashikuara në këtë strategji.

Edukimi dhe formimi i konsumatorit synon rritjen e ndërgjegjësimin të publikut për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare. Kjo i shërben vetë publikut për një orientim më të mirë gjatë vendimmarrjeve të tij për investime apo edhe për financat private. Mendoj se tematikat e tregut financiar duhet të përfshihen edhe në kurrikulat e arsimit të detyrueshëm arsimor, gjë që do të mbështeste këtë iniciativë për edukimin financiar të publikut.

Duke pasur parasysh rritjen e aktivitetit dhe të kompleksitetit të tregjeve nën mbikëqyrje mendoj se duhet të vijojë puna për rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e mëtejshëm të tyre, sidomos të stafit të departamenteve rregulluese dhe mbikëqyrëse të Autoritetit.

Në mbyllje të fjalës sime theksoj se jam e gatshme dhe e motivuar për të vijuar të punoj me të njëjtin ritëm, me të njëjtën dëshirë, përkushtim dhe integritet në përmbushjen e objektivave të Autoritetit, për përmbylljen me sukses të projekteve dhe punëve në proces, si edhe për të synuar projekte akoma më sfiduese në të ardhmen.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ka pyetje, komente nga deputetët?

Po, zoti Haxhinasto.

Edmond Haxhinasto - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Kaçi për prezantimin tuaj!

Unë kam disa pyetje dhe do t’ju kërkoja që të përgjigjeshit sa më shkurt që të jetë e mundur.

Zonja Kaçi, si e shpjegoni ju që të gjithë buxhetorët, institucionet buxhetore që janë *watch dog* të sistemit, nuk ngrenë probleme të mëdha për financat publike apo për investimet e huaja, nuk janë prezente në diskursin politik dhe në vendimmarrjet e rëndësishme me zërin

e tyre? A mund të thoni një problem që e keni evidentuar gjatë mandatit tuaj të mëparshëm me politikat, me problemet, me ecurinë, me planet që ka pasur institucioni juaj? A është ngritur ndonjë problem gjatë kësaj periudhe?

Pyetja e dytë, më intereson shumë të di, ka qenë çështje e diskutueshme edhe këtu në komision edhe në debatin politik, qëndrimin tuaj për PPP-të. Çfarë qëndrimi keni ju për PPP-të? Meqenëse jeni marrë me investimet dhe gradën shkencore e keni për investimet, me sa kam parë, kemi pasur dy përjasje të ndryshme: një përjasje nga ana e maxhorancës që thotë se detyrimet vjetore nuk janë pjesë e borxhit dhe institucionet ndërkombëtare, opozita ka thënë: po, këto janë pjesë e borxhit. Ju si e gjykoni në formimin tuaj?

Pyetja e tretë, në gjykimin tuaj çfarë duhet të përmirësohet për të thithur më shumë investime të huaja në Shqipëri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Jorida, mos ndërhy, e drejtoj unë mbledhjen! Çfarë e keni këtë zakon?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Opozita apo pozita nuk ka të drejtë të flasë si të dojë.

Zoti Haxhinasto do të preferoja që të fokusoheshit te rendi i ditës, te pyetjet që kanë të bëjnë me institucion dhe me zonjën në pozicionin e saj.

Edmond Haxhinasto - Unë po fokusohem te pyetjet që kanë të bëjnë me zonjën, sepse do të jetë zëvendësdrejtoreshë atje.

Arben Ahmetaj – Ti pyet për PPP-të. Çfarë lidhje kanë PPP-të me AMF-në?! Megjithatë është në të drejtën e zonjës që të përgjigjet ose jo.

Edmond Haxhinasto –PPP-të janë tregu financiar jo bankar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, absolutisht. A janë investime PPP-të?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj- Kur merr pjesë buxheti është investim publik, instrument investimi publik, ndërsa kur kontribuojnë të dyja është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Haxhinasto - Privati investon, madje ai thotë, ka ulur kredimarrjen.

Arben Ahmetaj – *Sher holding* nuk është institucion financiar jo bankar.

Edmond Haxhinasto- Pak rëndësi ka. Unë po bëj pyetjet, nëse zonja thotë që kjo nuk është pjesë e paketës sime, të na përgjigjet shkurt. Unë kështu e gjykoj, kështu e mendoj.

Arben Ahmetaj - Zonjë, përqendrohuni tek institucioni!

Edmond Haxhinasto- Pra, çfarë duhet të përmirësohet për angazhimin e tregut financiar jo banka, për ta zhvilluar më tej, pasi janë disa detyra të vendosura prej kohësh për të, të cilat nuk janë realizuar edhe në fushën e bursës edhe në fusha të tjera? Në gjykimin tuaj cilat janë ato? Nëse e gjykoni se nuk i përgjigjeni, mund ta thoni shumë shkurt se nuk i përgjigjeni pyetjeve.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Kaçi.

Mimoza Kaçi – Për pyetjen e parë dua të sqaroj se AMF-ja është një autoritet i pavarur dhe nuk është i financuar nga buxheti i shtetit. Pyetja juaj nuk ka asnjë relevancë me punën tonë dhe me llojin e institucionit për të cilin unë sot kam ardhur të aplikoj për nëndrejtores ekzekutive.

Për sa u përket PPP-ve, nuk është në objektin e punës sonë, por ka pasur vende të cilat këto lloj bashkëpunimesh të partnerëve privatë dhe shtetërorë kanë sjellë zhvillime shumë të mëdha në ekonominë e vendit, kryesisht për ndërtimin e veprave infrastrukturore. Këto i kanë dhënë hov në disa vende edhe zhvillimit të tregut financiar jo bankë nëpërmjet emetimit të obligacioneve.

Për sa i përket pyetjes së fundit, do të dëshiroja të ndalesha, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me punën e Autoritetit. Tregu financiar jo bankë vazhdon ende të jetë i zhvilluar në limite. Ka ende shumë për të bërë. Unë do të thosha atë shprehjen: punët e mira bëhen avash-avash, sepse janë tregje shumë të ndjeshme. Duhet të punohet shumë për rritjen e edukimit financiar, sepse kemi një nivel shumë të ulët. Shqipëria është e fundit ndër të gjitha vendet e rajonit për sa i përket nivelit të informimit financiar. Kjo do t'i bënte edhe më të ndërgjegjshëm individët dhe konsumatorët. Përveç formave tradicionale të depozitave në bankë apo të kreditimit nëpërmjet sistemit bankar ka edhe kanale të tjera ku ata mund të përfitojnë më tepër nëpërmjet shfrytëzimit të këtyre alternativave.

Nga ana tjetër tek tregu i fondeve të investimit shikoj mundësinë për zhvillimin e llojeve të reja të fondeve investuese dhe ka një interes të veçantë. Siç e përmenda është draftuar tashmë ligji i ri, i cili është ende draft, po punohet dhe shpresojmë që në muajt në vijim ky draft të përfundojë dhe miratimi i këtij ligji dhe ligjit “Për titujt” t'u japë një zhvillim dhe një dimension të ri zhvillimit të këtyre tregjeve.

Ne kemi licencuar bursën e parë me kapital privat në vend, e cila filloi aktivitetin në shkurt të vitit të kaluar. Aktualisht aty tregtohen letrat qeveritare, por në vijim ajo do të fillojë edhe me letrat me titujt të kompanive, të kooperatave, obligacione. Po punohet për ndërtimin e kuadrit mbikëqyrës të bursës, sepse kjo kërkon edhe një transparencë më të

madhe nga ana e kompanive, duke filluar që nga bilancet e tyre, që duhet të jenë shumë të mirëkontrolluara dhe të shoqërohen me masa të tjera për uljen e informalitetit. Mund të them se është bërë shumë gjatë këtyre viteve.

Për tregun e sigurimeve edhe këtu do të theksoja rritjen e besimit të konsumatorit në këto tregje. Viti i kaluar ka qenë viti me pagesat më të mëdha të dëmeve, raporti dëme- prime gjatë vitit 2018 ka arritur në nivelin mbi 40% , gjë që mund t'ju konfirmoj. 41% në total tregu, nga 34% që ka qenë vitin e kaluar.

Pak a shumë këto janë pikat që unë doja të ndalesha në vija të përgjithshme.

Edmond Haxhinasto - Ka qenë lapsusi im nëse kam thënë buxhetor, por e kisha publike shtetërore. Ju i tillë jeni si institucion. Pyetja ishte: a keni evidentuar ndonjë problem, a e keni ngritur çështjen për ndonjë problem që ka pasur fusha e përgjegjësisë suaj gjatë gjithë mandatit tuaj? Unë e di që ju nuk jeni buxhetorë, e kisha fjalën për institucione shtetërore. Mënyra sesi funksionojnë institucionet shtetërore publike dihet tashmë se çfarë varësie krijohet ndaj maxhorancave.

(Zoti Haxhinasto flet pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Një sekondë, zonja Mimoza flitet me leje në komision!

Mimoza Kaçi – AMF-ja është një autoritet i pavarur, ligji i vitit 2014 e ka rritur pavarësinë e tij. Rritja e pavarësisë ka konsistuar në dy pika: në rritjen e pavarësisë financiare. Ne sot kemi të drejtën për të miratuar me vendim bordi duke filluar nga buxheti i Autoritetit, nga struktura organizative. Kjo rritje e pavarësisë ka pasur si qëllim rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit, sepse duke qenë pjesë e ligjit buxhetor edhe skema e pagave ishte e tillë që nuk mund të rekrutoje personat profesionistë për shkak të nivelit të kufizuar të pagave. Kjo bëri që ne të kishim një lloj pavarësie për të punësuar profesionistët e tregut dhe për të arritur të mbikëqyrë me efektivitet këto tregje, që është gjë shumë e rëndësishme. Janë tregje shumë të ndjeshme, zhvillime të vogla mund të shoqërohen edhe me pasoja të mëdha për të gjithë tregun financiar, prandaj kjo ka qenë një domosdoshmëri. Unë personalisht nuk kam evidentuar ndonjë problematikë. Ne kemi hartuar gjatë këtyre viteve strukturën organizative e kemi përmirësuar dhe kemi qenë më fleksibël në momente kur na është dashur për ta adaptuar apo për ta përmirësuar atë.

Skema e pagave ka qenë e tillë, për të motivuar profesionistët dhe në të gjithë këto procese është ndjekur pak a shumë logjika e funksionimit të rregullatorit të parë në vend që është Banka e Shqipërisë. Edhe ligji “Për AMF”-në kur është draftuar është marrë si model po ky ligj.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Po, zoti Spaho.

Edmond Spaho - Dua të bëj një koment. Nuk kam asnjë rezervë me kredencialet e nëndrejtoreshës, janë solide, veçanërisht studimet që ka bërë në Vjenë, por kam një problem me ligjin. E kam ngritur këtë çështje në kohën kur u mor iniciativa ligjore për të ndryshuar ligjin "Për AMF"-në. Praktika për të pasur në bord anëtarë të ekzekutivit nuk mendoj se është më e mira, nuk përputhet me praktikën ndërkombëtare. Iniciativa atëherë u mor nga zoti Braçe, për të ndryshuar strukturën e institucionit, madje në disa raste përshtypja ime ishte që u përpoq të ushtrojë edhe presion ndaj institucionit. Jemi marrë për një kohë të gjatë me AMF-në, mendoj se ka ardhur koha t'i kthehemi normalitetit, pjesa ekzekutive të ndahet nga pjesa e bordit, pasi pjesa ekzekutive raporton te bordi, bordi i kërkon llogari, mbikëqyr pjesën e ekzekutivit.

Zoti kryetar, ju bëj thirrje që ta thërrësim zëvendëskryeministrin një ditë në komision dhe ta vëmë në rrugën e zgjidhjes këtë çështje.

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Spaho!

Nëse doni të ndërmerrni një iniciativë ligjore, jeni i mirëpritur.

Edmond Spaho - Unë e di që iniciativat nuk miratohen, por i bëj thirrje profesionalizmit tuaj, kur them tuajin...

Arben Ahmetaj- Më ndërpreve. Unë nuk të ndërpres asnjëherë, ndërsa ti më ndërpret gjithmonë. Do ta thërrasim zotin Braçe në funksionin e zëvendëskryeministrit.

Edmond Spaho - Unë nuk di ndonjë bord që të ketë pjesë nga ekzekutivi. Ky është rasti i vetëm i AMF-së.

Arben Ahmetaj- Më falni!

Bëni kërkesë, çfarë të doni, cilin të doni, zotin Braçe, ministren për Marrëdhëniet me Kuvendin që të vijë këtu në komision. Nëse doni të ndërmerrni një iniciativë ligjore, jeni të mirëpritur, jam në dispozicionin tuaj.

Faleminderit, zoti Spaho për sugjerimin!

Po, zonja Tabaku.

Jorida Tabaku - Zoti kryetar, unë theksoj edhe një herë rastin se ju përsëri jeni në konflikt interesi si në rastin e aktit normativ. Ky është një propozim i ardhur nga ju si ministër i Financave. Në këtë komision besoj se të paktën në propozime ose në votim asnjëri nga ne nuk duhet të ketë konflikte interesi.

Unë kam një pyetje për zonjën, Komisioni për Ekonominë vjet ka zhvilluar në mos gaboj seanca pafund me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me problematikat që kishte ky Autoritet. Raporti i Komisionit për Ekonominë nuk ishte zbatuar, raportimi vinte i

mangët, ka pasur problematika me Fondin e Kompensimit. Sugjerimi i Komisionit për vitin paraardhës sugjeronte Fondin e Kompensimit në 100%, u mor edhe angazhimi nga institucioni. Pra, ka pasur problematika pafund. Pse duhet që ky komision t'ju mbështesë kur nën drejtimin tuaj këto problematika nuk janë ezaurur, rekomandimet e Komisionit për Ekonominë nuk janë zbatuar dhe për më tepër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kaq qenë i vetmi autoritet që ka ardhur këtu në komisionin tonë mbi 8 herë si rezultat edhe i shqetësimeve që kishin kryesisht anëtarët e maxhorancës?

Arben Ahmetaj - Zonja Kaçi, shkurt në referencë të pyetje së zonjës Tabaku.

Mimoza Kaçi - Për sa i përket pagesës së dëmeve unë mund t'ju siguroj se viti i kaluar ka qenë viti me pagesën më të lartë të dëmeve, gjë që e theksova edhe pak më parë. Ne kemi miratuar dy shtesat e fundit të kompensimit. Pra, ne bëjmë miratimin e fondit të kompensimit në fillim të vitit. Ky fond është pasuruar me dy shtesa të tjera dhe ka qenë fondi i kompensimit më i larti i miratuar ndonjëherë në historinë e Autoritetit, jo vetëm i miratuar, por është ndjekur hap pas hapi edhe përmbushja e pagesave nga ana e kompanive dhe është bërë një punë shumë e madhe dhe është arritur që raporti prime /dëme për këtë vit pritet të jetë mbi 40%, ndërkohë që ka qenë 34% në këtë nivele për shumë vjet me radhë dhe ka mbetur po në këto nivele.

Ajo çfarë Autoriteti mund të bëjë është miratimi i këtij fondi dhe marrja e masave të tjera shoqëruese. Pjesa tjetër pastaj mbetet pjesë e kompanive, po prapë ju siguroj që është vijuar me pagesat.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Tabaku!

Jonida Tabaku - Nuk mora përgjigje për asnjë pyetje dhe për asnjë shqetësim që ngrita. Pse Komisioni i Ekonomisë i ka thirrur 8 herë institucionin, kryesisht përfaqësues të maxhorancës, për shqetësimet që kanë për moszbatimin e rekomandimeve?

Unë ju dëgjova shumë mirë dhe qartë kur thatë se është arritur në masën 41% të fondit të kompensimit, ndërkohë që në rezolutë thuhet se do të tentojmë të shkojmë deri në 100%. Pra, kisha disa shqetësime, të cilat nuk dëgjova që t'u përgjigjeshit.

Pse duhet t'ju mbështesim ju si Komision Ekonomie kur në periudhën tuaj nuk ka pasur asnjë përmirësim, në mos gaboj nga viti 2014 e këndeje, dhe ka qenë i vetmi institucion që vitin e kaluar ka ardhur tetë herë për të raportuar këtu?

Kryetar, marr shkas që të ngre edhe një çështje procedure.

Në këtë komision u bë e disata herë (nuk ka lidhje me drejtimin tuaj), që maxhoranca sjell propozime (ky është një propozim i Ministrisë së Financave, i juaji personalisht), por këtu u referohem edhe institucioneve të tjera (nesër kem një kandidaturë

tjetër), që opozita lihet totalisht jashtë procesit. Këtu i referohem Bankës së Shqipërisë, i referohem Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare, i referohem një sërë institucionesh të tjera, të cilat janë institucione të pavarura dhe duhet të kenë përfaqësimin e opozitës.

Para vitit 2013 është ruajtur një raportim i propozimit nga forcat e ndryshme politike, sa herë ato ishin nga parlamenti. Sigurisht që qeveria, ministria e me radhë, kanë propozimet e tyre, por në rastin e parlamentit opozita ka qenë gjithmonë pjesë. Nisi me propozimet e kaluara në Agjencinë e Mbikëqyrjes Financiare, vazhdoi me Bankën e Shqipërisë në mënyrë të paprecedentë, që nuk kishte ndodhur asnjëherë, dhe ka vazhduar edhe me shumë institucione të tjera.

Që nga viti 2013 e këndeje opozita ka vetëm një përfaqësues në Autoritetin e Konkurrencës dhe asnjë përfaqësues tjetër në asnjë institucion të pavarur.

Kushtetua është e ndërtuar në mënyrë të tillë, ligjet që rregullojnë këto institucione, Rregullorja e parlamentit janë rregulluar në mënyrë të tillë që të gjenden balancat, jo të përfaqësimit politik, por balancat e përfaqësimit të mendimit ndryshe në këto institucione. Nuk ka ndodhur asnjëherë që hapësira e opozitës të jetë e ngushtuar në këto limite.

Zonja është propozim i Ministrisë së Financave dhe sigurisht që është në të drejtën e Ministrisë së Financave që ta propozojë, por këtu kemi kaluar institucione pa fund dhe nuk është përfshirë opozita asnjëherë në proces dhe nuk është bërë asnjëherë pjesë e këtij procesi.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Në rastin konkret besoj se iu referuat një konflikti i interesi. Ligji i konfliktit të interesit është shumë i qartë. Edhe sikur ta kisha parashikuar që do të lëvizja nga ministër i Financave dhe do të vija këtu, të njëjtën gjë do të bëja për procesin, sepse është bërë një proces po ta shkoni në dosje dhe s'ka lidhje fare me zonjën Kaçi, por ka lidhje me procesin dhe zonja Kaçi është konsekuencë, në këndvështrimin tim, shumë pozitive e atij procesi.

Ndërkohë, opozita ka qenë e ftuar përmes procesit ligjor, që të sillte kandidatura të mbështetura nga opozita. Nuk besoj se ligji ka ditë-hije politike në procedurë, por gjithsesi dikush mund të mbështetej edhe nga ju.

Institucionet e kanë ekuilibrin në bazë të ligjit. Mos harroni se KLSH-ja ka 16 vjet që drejtohet nga përfaqësuesit e opozitës. Gjatë gjithë kohës KLSH-ja ka pasur kryetar nga opozita, madje kanë ardhur deputetë, kanë ardhur ministra nga radhët tuaja që kanë drejtuar KLSH-në.

Gjithsesi, në referencë të asaj që thatë, në rastin e sotëm është prerogativë e një institucioni specifik, që është Ministria e Financave, ndërsa nesër që kemi anëtarët dhe kryetarin e bordit. Ky ka qenë një proces i hapur dhe unë shpresoj që dikush nga kandidaturat

të ketë edhe asocim të djathtë apo të mbështetur nga opozita (shpresoj, nuk është se është kusht në ligj).

A ka ndonjë koment tjetër?

Urdhëroni!

Jorida Tabaku – Urdhri për zonjën është shpallur dhe është publikuar në faqen e Ministrisë së Financave me datën 28 dhjetor 2018, ndërkohë që ju jeni njoftuar që do të largoheni nga ky pozicion më 26 dhjetor, kështu që ka një konflikt të mundshëm interesi, sepse e dinit që do të iknit dhe do të ishit me shumë mundësi anëtar në këtë komision.

Shqetësimi që unë ngrita, përveç këtij rasti që thashë, është prerogativë i Ministrisë së Financave që lidhet me përfaqësimin në të gjitha institucionet e tjera.

Në qoftë se hapësira e opozitës ngushtohet në këtë farë mënyre dhe në qoftë se përfaqësimi i opozitës ngushtohet në këtë farë mënyre, për mua për momentin nuk ka asnjë problem. Arroganca e pushtetit fillon pikërisht atëherë ku i merrni të gjitha pushtetet, pro do të ishte normale që në gjitha këto institucione të kishte një debat dhe një diskutim për përfaqësimin e opozitës.

Nuk kemi marrë asnjë njoftim për Agjencinë e Mbikëqyrjes Financiare. Kemi marrë një njoftim për Bankën e Shqipërisë, të cilin prisnim ta ezauronim bashkë me LSI-në, siç i takon ndarjes normale të firmave në parlament, por, fatkeqësisht, e shkelët përsëri Kushtetutën dhe i bëtë propozimet e njëanshme dhe çuat, për herë të parë, propozime pa firmat e opozitës.

Arben Ahmetaj – Zonja Tabaku, besoj se ishte pjesa politike e këtij procesi teknik.

Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje për zonjën? Nuk ka.

Faleminderit!

Zonjë, faleminderit për prezantimin!

Media të jetë prezente për të ndjekur procesin e votimit!

Kush është pro kandidaturës së zonjës Kaçi për anëtare bordi, në mbajtjen e pozicionit nëndrejtor i përgjithshëm i AMF-së.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Kandidatura e zonjës i kalohet Kuvendit për votim ditën e enjte.

Suksese!

Një njoftim për komisionin. Nesër kemi planifikuar një seancë për kryetarin e bordit të AMF-së.

CV-të ju janë nisur në mënyrë elektronike.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti